

KËTË HERË NUK DOT KALONI!

Pushteti na çon drejt shkatërrimit. Jo se kjo është diçka e re, por ditëve të fundit punët marrin përshpejtim të frikshëm. Zënka mes të rinjve shqiptarë dhe maqedonas është edhe një dëshmi e shëmtuar për natyrën e pushtetit aktual. I ashtuquajturi “muze-kish” është edhe një nga zjarret e shumta të iniciuar nga ato të cilët janë të përgatitur në gjithçka për të ngelur në pushtet të paktën edhe një ditë më tepër. Ndiz që të mund të shuash – kështu thotë direktiva e ditës të cilën Gruevski dhe Ahmeti na bënë më të errët se nata.

Ne, “Qytetarët për Maqedoni Evropiane”, nuk do ta shohim me duar të kryqëzuara “ndezjen e Rajhsagut”. Nuk do të futemi në strehimore dhe ti shohim nga anash orvatjet e reja për ta ndezur Maqedoninë. Do të kundërshtojmë. Para së gjithash me fjalë, ashtu siç luftuam kundër gruevizmit në tre vitet e kaluara. Arsyes, trimërisë dhe patriotizmit në vendin tonë nuk i ngelën asgjë tjetër përveç se ti kundërshtohen gruevizmit. Ashpër ti kundërshtohen pushtetit i cili në fazën e fundit të egërsisë së vet dëshiron të tërheq me vete gjithë vendin. Do të duhet ti ja presim rrugën pushtetit i cili me zjarre dëshiron ta ndalën dritën në hanin ballkanik. Që mos të dihet kush është rrahësi, e kush i rrahuri, kush është i dehuri e kush i hutuar.

E kemi të njohur mënyrën më të cilën Gruevski deri sot i “zgjidhte problemet”: problemet e vogla i tejkalonte duke krijuar më të mëdha. Strategjinë e njëjtë “bariu” e përdori edhe pas disfatës historike të Republikës së Maqedonisë para tre viteve. Për disfatën (e shpallur si arritje patriotike nga propagandistët e tij) Gruevski u shpërblye nga populli me pothuaj pushtet absolut. Tani gruevizmi bëhet gati për manovrën e njëjtë. Pas gjitha disfatave të turpshme të cilat vendi i përjetoi

në pesë vitet e fundit na pret edhe një. Me të duhet që si me gomë magjike të fshihet egërsimi pesëvjeçar i pushtetit të çoroditur. Edhe njëherë do të duhet të rrihemi që kokat tona ti harrojnë premtimet e djeshme të rrejshme për një Maqedoni më të pasur, më të drejtë dhe evropiane.

Në vend të vizioneve të qarta për ardhmërinë e vendi tonë, pas disfatës në Bukuresht, gruevistët na ofruan që të “rilindemi” në “Shkupi 2014”. Qytetarëve u ofruan ide megalomane për ndonjë lloj kryelartësi nacionale kurse për vete i grabitën provizionet nga kontratat në vlerë prej qindra milionë eurosh. Patriotizmi na u shpall si strehim i fundit nga një sërë fagezish.

Rasti me TV A1 dhe tre gazetat opozitare tregoi se pushteti orvatet ti shkatërron të gjithë ata të cilët nuk mendojnë si ai. Sot në Maqedoni kauza publike është anuluar nga terrori i pushtetit. Në vend të interesit publik sundon ai banditesk. Profitet e tyre i bluajnë interesat shoqërore. Centrifuga e shtetit të gjithëfuqishëm partiak gëlltit gjithçka; pavarësia dhe autonomia tani më nuk lejohen askund. Madje edhe në kulturë e më pak në arsim, ekonomi apo në medime!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Maqedonisë, duam që edhe njëherë tu porosisim: vetë e krijojmë fatin tonë. Nëse edhe një herë lejojmë të luajnë me ne forcat më të errëta politike – atëherë atë edhe e kemi merituar. Në vend që të ngelim mes kopeve etnike dhe fetare, koha është që më në fund qartë dhe zëshëm tu porosisim gruevistëve dhe nxitësve tjerë:

Këtë herë nuk dot kaloni!

Shkup, 18 shkurt 2011